

Këshilli i Lartë Gjyqësor
Drejtoria e Auditit
Raporti Vjetor
2019



I. Permbledhje Ekzekutive

II .Baza Ligjore

III.Organizimi

- **Misioni i auditimit te brendshem**
- **Organizimi i NjAB**

IV.Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

- **Analiza e programeve të auditimit per periudhen raportuese**
- **Analiza e misioneve te auditimit**
- **Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre**
- **Gjetjet kryesore sipas sistemeve**
- **Vleresimi i sistemeve te kontrollit te brendshem**
- **Ceshtjet e derguara per investigim**

V.Rekomandimet

- **Rekomandimet e propozuara**
- **Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit**

VI.Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilesise

VII.Analiza e Kapaciteteve Audituese

- **Probleme te konstatuara ne lidhje me funksionimin e NJAB**
- **Kapacitetet audituese**
- **Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve**

VIII.Konkluzione

- **Konkluzione mbi problematiken e punes audituese**
- **Prioritetet per vitin 2020.**

I. Përmbledhje Ekzekutive

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcjell sipas kërkesave dhe standarteve të auditimit, Raportin e vitit 2019 për veprimtarinë e saj Janar- Dhjetor 2019, sipas detyrimit të nenit 14, pika “ç” e Ligjit nr. Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe të Kapitullin IV, pika 4.3 e Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Ky raport pasqyron përmbushjen nga Drejtoria të aktiviteteve të auditimit të realizuara për periudhën në fjalë, në krahasimin me detyrimet e planifikuara dhe objektivat e caktuara. Raporti gjithashtu siguron të dhëna statistikore të paraqitura në tabelat bashkëlidhur dhe të hartuara sipas formatit të unifikuar nga Drejtoria e Harmonizimit për AB, duke specifikuar një sërë treguesish të arritur, të dalë nga raportet e auditimeve të përfunduara për këtë vit. Përveçse qëllimit raportues këta tregues, të cilët pasqyrojnë performancën e punës së drejtorisë, do të jenë objekt i analizës së performancës, vlerësimit të cilësisë së shërbimit, etj., për të siguruar një tendencë pozitive në rritje të treguesve në terma afatshkurtër e afatgjatë.

- **Së pari:** Qëllimi ynë është të realizojmë vetëvlerësimin e efikasitetit të drejtimit të financave të gjyqësorit, duke kontribuar në shtimin e vlerës së tyre dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke e asistuar në mënyrë të vijueshme Kryetaren e K.L.GJ-së, Anëtarët e KLGJ-së, Kryetarët e gjykatave dhe nëpunësin autorizues. Për këtë qëllim, ne shohim nga e ardhmja duke synuar që të aplikojmë metodologjitë dhe teknikat më të mira bashkëkohore për të përmirësuar planifikimin për auditim, maksimizimin e kapaciteteve të skuadrës audituese dhe zgjerimin e mbështetjes në arritjen e objektivave dhe prioriteteve të pushtetit gjyqësor me qëllim ofrimin sa më të mirë të shërbimeve gjyqësore për taksapaguesit.

Ndryshimi i imazhit të këtij shërbimi është një tjetër synim të cilin kërkojmë të arrijmë në terma afatshkurtër, duke informuar publikun dhe aktorë specifikë, mediat, etj., për të përcjellë perceptimin se ky shërbim profesional dhe i pavarur, është në shërbim të mbrojtjes së interesave të tyre.

- **Së dyti:** Ky raport paraqet përgjegjshmërinë e realizimit të programit të auditimit në vitin raportues. Ai trajton menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standardet profesionale të auditimit. Në këtë këndvështrim, raporti është në pajtueshmëri me kërkesën për përgjegjshmëri dhe reformat që qeveria po kryen në sektorin publik në Shqipëri dhe implementimi në pushtetin gjyqësor.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë të pasqyruara në raportet e auditimit të dërguar çdo gjykatë. Janë dhënë gjithësej 194 rekomandime për vitin 2019, për përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive.

Të gjitha subjektet e audituara, i janë përgjigjur rekomandimeve të auditimit për korrigjimin e parregullsive, duke dëshmuar se ato kanë qënë të duhurat dhe se kanë ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e vlerës së subjekteve publike.

- **Së treti:** Komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik në gjykata dhe tregon efikasitetin e qeverisjes në gjyqësor. Raporti përmban problemet më të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara, tregon ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korrigjuese, si dhe sfidat e përpjekjet e pandërprera, për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ të parashikuar në aktivitetin ekonomik e të shërbimit gjyqësor.

Vizioni shkon përtej qasjes tradicionale të fokusuar në vlerësime dhe konstatime. Audituesit e brendshëm publikë e realizojnë aktivitetin e tyre jo vetëm duke vepruar ,por duke bashkëvepruar nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të subjekteve publike të audituara për të maksimizuar vlerën e parasë publike në gjyqësor. NJAB do të vazhdojë të veprojë si një agjent ndryshimi, në shërbim të qytetarit dhe të qeverisjes së mirë, duke reflektuar vlerat dhe parimet e AUDITIMIT modern Vlera dhe Përfitimet e SHËRBIMIT TË AUDITIMIT NË GJYQËSOR - Një ndryshim e përmirësim në jetën e qytetarëve me shërbime gjyqësore cilësore. Këto parime përcaktojnë mënyrën sesi NJAB-ja duhet të performojë për të forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësisë të gjyqësorit; demonstruar rëndësinë e në zbatim të tetë parimeve: - **Pavarësia - Integriteti - Profesionalizmi - Objektiviteti - Bashkëpunimi - Interesi Publik - Përgjegjshmëria – Transparenca.**

II. Baza Ligjore

Strukturat e auditimit të brendshëm përmbushin përgjegjshmëritë e tyre sikurse përcaktohen në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, Manualin e Auditimit, Kartën dhe Kodin e Etikës për audituesit nëpërmjet implementimit të Planit Vjetor, i cili përcakton qartë objektivat për t’u arritur, treguesit e matjes së performancës së auditimit, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut.

Kuadri, ligjor dhe procedural i auditimit të brendshëm përfaqësohet nga:

1. Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i cili shpjegon se Ministri i Financave, ndër të tjera, është përgjegjës për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Për të ushtruar këto përgjegjësi, ai mbështetet nga **struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm** në Ministrinë e Financave.
2. Vendimi Nr.12 datë 23.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbledhur më datë 18.01.2019, mbështetur në Kreun II, nenet 59, e vijues të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
3. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, që përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.
4. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014 – 2020, miratuar me VKM nr. 908, datë 17.12.2014 “Për Miratimin e Strategjisë Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike 2014 – 2020” e cila në Shtyllën 5, ‘Kontroll Efektiv i Brendshëm’, për pikën lidhur me Auditimin.
5. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, miratuar me VKM nr. 348, datë 11.05.2015 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020”, në përmbajtjen e saj përcakton objektivat për auditimin publik në Shqipëri, Kapitulli 9, paragrafi 5 “Forcimi i kontrollit të brendshëm të sektorit publik, me qëllim përmirësimin e fondeve publike dhe llogaridhënies së menaxherëve nëpërmjet: 5.3- forcimit të aftësive profesionale të audituesve për t’u dhënë atyre mundësi të kryejnë auditime në përputhje me standardet ndërkombëtare”.
6. Plani Strategjik për Vitet 2018 – 2021 për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik përcakton objektivin strategjik të funksionit të auditimit të brendshëm për këtë

periudhë: nxitja e politikave për qeverisje të mirë, përmirësim dhe forcim të sistemeve të kontrollit të brendshëm në terma të efikasitetit, ekonomisë dhe efektivitetit në të gjithë subjektet e sektorit publik në Shqipëri.

7. Planet Vjetore të konsoliduara “Për veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik” përcaktojnë objektivat kryesorë të auditimit të brendshëm gjatë vitit 2019.

Zbatim të Ligjit nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.

Paketën ligjore të organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor.

Kuadrin e Praktikave Profesionale Ndërkombëtare, i cili përmban Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikave Profesionale të publikuara nga IIA.

Dokumentet janë udhëzuesit kryesorë për krijimin dhe zhvillimin e një sistemi modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri, si një nga kërkesat themelore për integrimin European të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

III. Organizimi

▪ Organizimi, përbërja dhe funksionimi i strukturave të auditimit.

Në bazë të vendimit Nr.12 datë 23.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbledhur më datë 18.01.2019, mbështetur në Kreun II, nenet 59, e vijues të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Auditimi i brendshëm është i organizuar në Drejtori e Auditimit të Brendshëm. Aktualisht struktura e auditit ka në përbërje të saj 5 punonjës përkatësisht:

- Drejtues i NJAB 1.
- Inspektor auditi 4.

Vartësia e Drejtorisë së auditimit është nga Titullari i Institucionit

Numri i përgjithshëm i subjekteve që auditohen nga njësi është 39.

▪ Misioni

Veprimtaria e auditimit të brendshëm ka si mision vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes së gjyqësorit dhe jep siguri të arsyeshme nëse :

- informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- asetet janë ruajtur;
- veprimtaritë e gjykatave janë në pajtueshmëri me politikën, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara;
- objektivat kryesorë të përcaktuara në programet dhe planet do të arrihen.
- kontabiliteti prodhon raporte financiare të sakta;
- në tërësi është ngritur dhe funksionon një sistem kontrolli funksional;

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar të pushtetit gjyqësor.

Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikave të mira Europiane.

Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike dhe shërbimeve gjyqësore në tërë gjykatat si konsumator të parasë publike.

Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike gjyqësore.

IV. Rezultatet e veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

NJAB ka rekomanduar një sërë masash që në gjykim të saj, do të mundësojnë jo vetëm implementim të plotë të kërkesave të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” duke ndikuar kështu në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, por do të garantojnë edhe monitorimin e kujdesshëm me qëllim adresimin e risqeve e dhënien e garancisë së mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive dhe të efektshme në gjyqësor.

▪ Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, dhe të Kapitullit III, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, auditimi i ushtruar ka synuar të përfshijë ato subjekte në varësi të saj, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ajo funksionon.

Bazuar në Kapitullin III, pika 3.6, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, veprimtaria audituese është orientuar në: auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të vendosura nga niveli i menaxhimit, Kryetarët e Gjykatave dhe KLGJ për vitin 2019, me qëllim përcaktimin nëse ato funksionojnë me kosto efektive, në mënyrë efçente dhe për arritjen e objektivave të gjyqësorit në fushën e administrimit publik ekonomik.

Jane planifikuar 13 auditime me bazë sistemi sipas Plani vjetor i NJAB-së, te miratuar për vitin 2019.

Kemi realizuar 12 auditime të plota me bazë sistemi dhe ka mbetur 1 gjykatë pa u audituar, përkatësisht Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Gjirokastër.

Planifikimi dhe realizimi i programit të auditimit për vitin 2019 paraqitet:




Figura 1. Realizimi i programit të auditimit.

Qëllimi ka konsistuar në përcaktimin nëse ato funksionojnë me kosto efektive, në mënyrë eficiente, me qëllim arritjen e objektivave të gjyqësorit në fushën e administrimit publik dhe ekonomik.

Shmangiet nga plani vjetor; Për vitin 2019 nuk ka patur shmangie nga plani i miratuar.

▪ Analiza e misioneve të auditimit

Në mënyrë të përmbledhur rezultatet e saj paraqiten si më poshtë vijon:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, ka zhvilluar veprimtarinë audituese bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet në fuqi, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës. Me qëllim garantimin e një efience sa më të lartë, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraparak të riskut, në përputhje me fushën për auditim. Secili proces auditues, është realizuar bazuar mbi Planin e Auditimit i detajuar për çdo fushë auditimi, në përputhje me objektivat që drejtimi dhe grupi i punës ka caktuar për secilin mision, si dhe në përputhje me natyrën e gjykates të planifikuar për t'u vënë nën auditim.

Raportet janë hartuar në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të specifika e cdo gjykate. Janë respektuar standardet në fushën e raportimit për sa i përket përmbajtjes, cilësisë, qartësisë dhe dobishmërisë së kësaj faze të procesit auditues.

Aktiviteti është bazuar mbi zbatimin e Planit Vjetor të miratuar për vitin 2019, si dhe rregullave ligjore në fuqi për rialokimin e burimeve të planifikuara me kërkesë të menaxhimit.

▪ Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre

Në Planet Strategjike dhe Vjetore të auditimit të brendshëm janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e gjykatave.

Për vitin 2019 kemi bërë vlerësim risku me tregues për çdo gjykatë dhe vlerësojmë pushtetin gjyqësor me një performancë pozitive dhe me risk të mesëm me tendencë drejt riskut të ulët që është një arritje domethënëse e pushtetit gjyqësor.

Në kapitullin III, pika 3.1.2, Identifikimi dhe Vlerësimi i Riskut të Manualit të Ri të Auditimit të Brendshëm, janë përcaktuar dhe metodologjitë që përdoren për identifikimin dhe vlerësimin e riskut dhe pikërisht bazuar në këtë sistem të vlerësimit të riskut, Njësia e Auditimit ka programe, ku do të programojë dhe auditimin e fushave dhe subjekteve që paraqiten me një nivel të lartë risku.

Menaxhimi i riskut është proces logjik dhe rregullohet nga Manuali e Ligji i MFK-së (Kontrolli dhe Menaxhimi Financiar).

Nga analiza e raporteve vjetore individuale si dhe nga intervistat e realizuara, rezulton se përcaktimi i nivelit të riskut është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut, të cilët në mënyrë të përmbledhur do të përgjithësoheshin në kategoritë e mëposhtme:

- Sasia dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të gjykatës të audituar;
- Zbatimi i ligjshmërisë, politikave, procedurave, rregulloreve e planeve;
- Arritja e objektivave dhe rezultateve të pritshme;
- Ruajtja dhe mirëadministrimi i aseteve, pronë publike;
- Funkcionet kryesore, organizimi dhe kompleksiteti i gjykatës që auditohet;
- Kërkesat e raportimit financiar;
- Mjedisi i kontrollit në gjykata;
- Shkalla e ndryshimeve organizative dhe në drejtim;
- Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën;

Duke u bazuar në përcaktimin e fushave me risk më të lartë sa më sipër, struktura audituese ka vendosur dhe prioritetet e saj. Kështu në subjektet apo fushat me risk më të lartë janë angazhuar të gjitha burimet e auditimit me kohë të gjatë auditimi, që do të thotë që në këto auditime është përfshirë staf më nivel të lartë profesional, dhe është siguruar kohë e mjaftueshme për vlerësimin e subjekteve.

Në auditimet me risk, ka marrë pjesë vetë drejtuesi i strukturës si në Gjykatën e Rrethit Tirane.

Megjithatë, si rezultat i rivlerësimit të riskut gjatë vitit dhe kur menaxhimi e ka gjykuar të arsyeshme, për fusha të cilat risku në situata të veçanta paraqitet më i lartë se vlerësimi në Planin Vjetor, do të kryhen dhe misione auditimi me urdhër të veçantë, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Atje ku risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve duke synuar jo vetëm përcaktimin e efekteve të shkaktuara apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin e përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen në pushtetin gjyqësor.

Bazuar në faktorët e përmendur më sipër vlerësojmë me risk më të lartë fushat në vijim:

1. Sistemet e menaxhimit e kontrollit financiar. Pjesa më e madhe e të audituarve gjykojnë se, pikërisht menaxhimi financiar është fusha ku risku është më i pranishëm. Po t'i referohemi analizës në seksionin "Gjetjet më të rëndësishme" të këtij raporti janë pikërisht fushat e transaksioneve financiare, sistemit të pagave në të cilat janë zbuluar dhe shkeljet më të rëndësishme.

2. Gjykatat që qarkullojnë shuma të konsiderueshme të fondeve publike të cilat sigurohen nga një numër i madh burimesh financimi, ku përfshihen dhe të ardhurat.

3. Investimet në godina të reja, ku përfshihet jo vetëm zbatueshmëria e kuadrit ligjor, por dhe shkalla e cilësia e implementimit të kontratave. Këto fusha shfaqen jo vetëm me risk të lartë financiar por dhe operacional, që ka të bëjë me cilësinë e punimeve, pagesat jo në konformitet me gjendjen aktuale të punimeve, mbikëqyrjen dhe marrjen në dorëzim të objekteve dhe garancia e standardi i punimeve, Gjykata Elbasan dhe Apeli Shkodër.

4. Gjykatat apo fushat me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, e cila shfaqet me mangësitë në kuadrin rregullator e procedural brenda vetë subjektit publik. Kjo ka të bëjë me gjykata të cilat kanë pësuar ndryshime strukturore dhe nuk e kanë plotësuar akoma bazën rregullatore dhe funksionale të tyre si dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe e rregulloreve të brendshme.

5. Menaxhimi i burimeve njerëzore. Qarkullimi i shpeshtë i stafit dhe niveli i ulët profesional i punonjësve ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave dhe cilësinë e punës.

6. Gjykata me nivel të ulët të njohurive dhe përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit. Njohuritë e pamjaftueshme për këto sisteme bëjnë që subjektet të ekspozohen në një shkallë të lartë të riskut pasi nuk mund të përshtaten dhe të përdorin sisteme të tilla që shpesh janë dhe të detyrueshme (psh. sistemi alfaweb, sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sistemi i përgatitjes së PBA-së, apo prokurimet publike) dhe e programit Alpha të aplikuar në vitin 2016. Për vitin 2019 konstatohet një përmirësim i mbajtjes së sistemit financiar nëpërmjet programit Alpha, disa gjykata kanë arritur të punojnë vetëm me program si dhe ka gjykata që punojnë paralelisht dhe në mënyrë ekstra kontabël dhe program. Ka gjykata që përpunojnë informacionet e tyre në mënyrë manuale, ku risku i gabimeve në llogaritje apo të dhëna shfaqet i lartë.

7. Përdorimi dhe përpunimi i të gjitha informacioneve me programin Alpha për të arritur në një unifikim të informacioneve financiare në të gjitha gjykatat është fakt i realizuar.

Jemi i vetmi aktivitet publik, që nuk kemi detyrime të fshehura dhe të dhena kontabile korrekte mbi pasurinë publike në administrim.

- **Gjetjet kryesore sipas sistemeve.**

Gjatë procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar mbi gjetjet e auditimit. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi i Gjykatave dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e Gjykatave është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm.

Për periudhën raportuese gjetjet e evidentuara dhe të paraqitura në pasqyrat përkatëse, paraqesin zbulimet dhe evidentimet të raportuara nga auditimet e kryera për vitin 2019.

Nga gjykatat kemi patur reagime pozitive në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Pas dërgimit të raportit final në çdo Gjykatë kemi informuar titullarin mbi përfundimin e çdo misioni auditues.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, pranë gjykatave të audituara, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për vitin 2019, janë dhënë gjithësej **194** rekomandime për përmirësimin e sistemeve si vijon:

- 1. Sistemi organizativ 43**
- 2. Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit 9**
- 3. Sistemi i prokurimit dhe blerjet e vogla 61**
- 4. Sistemi i pagave dhe pagesave 40**
- 5. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit publik 30**
- 6. Teknologjinë e informacionit 11**

Grafikisht paraqiten:




Figura 2: Gjetjet kryesore sipas sistemeve.

Më konkretisht: Vlera e përgjithshme e gjetjeve për shkeljet financiare nga angazhimet e auditimeve për vitin 2018, rezulton në shumën 622 mijë lekë dëm, ndërsa për vitin 2019 është 136 mijë lekë me e ulëta në historinë e auditimit në gjyqesor.

Këto dëme janë realisht të arkëtueshme në arkën e shtetit dhe ka filluar arkëtimi i tyre.

Të ndara sipas sistemeve/ fushave këto gjetje rezultojnë përkatësisht:

- Në sistemin e pagave dhe pagesave, në shumën 136 mijë lekë që përbën vlerën e dëmit ekonomik të arkëtueshëm në arkën e shtetit.

Krahasimi i vlerës së dëmit ekonomik për vitet 2018&2019 paraqitur grafikisht rezulton:




Figura 3. Krahasimi i vlerës së dëmit ekonomik për vitet 2018& 2019

Vlera e gjetjeve me dëm ekonomik në krahasim me vitin 2019 është ulur, ka dëme në prokurime e raportim publik si rrjedhojë e rritjes së nivelit të punës menaxhuese në Gjykata, por edhe lënies së rekomandimeve efikase dhe zbatimit të tyre nga NJAB-ja.

Të gjitha këto rekomandime janë dhënë në bashkëpunim me Kryetarët e Gjykatave dhe struktura e auditimit ka patur mirëkuptim për rekomandimet e dhëna.

Në përfundim të këtyre misionëve audituese është informuar KLGJ-ja, titullari dhe janë dërguar në Gjykata raportet finale për zbatim.

Rekomandimet e dhëna kanë qenë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim.

Në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare kemi patur si synim uljen në maksimum të mundësisë së përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

Krahasimi i rekomandimeve të dhëna dhe të pranura në vitet 2018 dhe 2019 paraqitet si vijon:




Figura 4. Krahasimi i rekomandimeve të dhëna dhe të pranuar në vitet 2018 dhe 2019

Për vitin 2018 janë dhënë gjithsej 180 rekomandime dhe për vitin 2019 janë dhënë 194 rekomandime.

Nga shqyrtimi i të dhënave si më sipër kemi rekomandime më shumë në vitin 2019 - 14 rekomandime.

Me numër më të lartë rekomandimesh rezultojnë sistemet organizative, të pagesave, prokurimit dhe raportimit publik në të cilat janë konstatuar mangësi kryesisht në azhurnimin e rregulloreve të brendshme të funksionimit në përputhje me ligjin e MFK-së, strukturave organike të Gjykatave dhe vendosjen e linjave të raportimit, në pagesat e avokatëve të thirrur kryesisht, ekspertëve, psikologëve, orët jashtë orarit, shtesa mbi pagë, dieta etj., që vjen si pasojë e disa problemeve që ka legjislacioni ekzistues (*avokatë, ekspertë, psikologë*), moskuptimit dhe moszbatimit të drejtë të legjislacionit nga ana e punonjësve që merren me zbatimin e tij, mungesës së kualifikimit dhe trajnimeve të këtyre punonjësve si dhe mungesës së profesionalitetit në disa raste.

■ REKOMANDIME SIPAS SISTEMEVE. 2019 dhe 2020.

➤ Sistemi organizativ

1- Ne kushtet e një situatë të re juridike në kuadër të reformës në drejtësi dhe në përputhje me nenin 37 germa “dhe” të Ligjit Nr.98, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, *nuk është rishikuar dhe përmirësuar Rregullorja e Brendshme*. Për sa kohë që kjo rregullore do të jetë në fuqi për ato pjesë të saj që nuk bien ndesh me ligjin dhe që janë të zbatueshme, deri në hartimin dhe miratimin e Rregullores standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave, nga KLGJ (me miratimin e përkrahjeve standarde të punës të punonjësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës) në përputhje me nenin 94 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

2.Në disa raste *mungojnë përshkrimet e punës/detyrat funksionale për pozicionet e punes* (magaznier, k/sekretar, sp.IT, arkivist, punonjës sigurie, nëpunës gjyqësor/ftus, ndihmës ligjor...etj). Mungojnë detyrat e nëpunësit zbatues sipas udhëzimit të Ministrit të Financave nr.21, date 25.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve” ...etj. Nuk janë të përfshira detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, konstatuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kurbin, Korçë, Mat, Lushnje dhe Shkoder.

3.Proçesi i përzgjedhjes të punonjësve administrativ nuk i është nënshtruar procedurës konkurruese të rekrutimit, transparente dhe merite sipas parashikimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për periudhen e audituar 2016-2019 nuk është vepruar në përputhje me nenin 19, pika 2 të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Me nenin 2, pika 1 të ligjit nr.7995, dt. 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar. Për plotësimin e vendeve vakant **nuk është ngritur komisioni ad-hoc**, për hartimin e kriterëve të veçanta/specifike të konkurimit, veç atyre të përgjithshme, për publikimin e vendeve vakant në një gazetë me tirazh të lartë, faqen zyrtare të Gjykatës dhe në këndin e njoftimeve të Gjykatës, hartimin dhe miratimin e procedurave të konkurimit me shkrim dhe intervistës me gojë, mbledhjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kërkuar në njoftimin e publikuar, dokumentimin dhe arkivimin e të gjithë procedurave, konstatuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kurbin dhe Korce.

Dosja personale e punonjesit nuk eshte plotesuar me të gjitha dokumentat që duhet të përmbajë dosja, sipas VKM-së Nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe të rregjistrimit qendror të personelit”. - Nuk është bërë **vlerësimi i punës të punonjesve** të gjykatës/performanca periodike, për rrjedhojë ky dokument mungon në dosjen personale të punonjesit, konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kurbin dhe Shkoder.

Regjistri themeltar i punonjësve nuk është plotësuar në të gjitha referencat e tij, nuk sekretohet/vertetohet e vulozet me vulën e institucionit në të gjitha faqet. Në referim të ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 63 “Dosja dhe Rregjistri Qendror i Personelit”, nuk është krijuar regjistri elektronik i personelit, për rrjedhojë nuk ka filluar hedhja e të dhënave profesionale, si dhe të dhëna të tjera në lidhje me marrëdhënien e punës për punonjësit, konstatuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Korce, Mat dhe Shkoder.

Në disa Gjykata në të njëjtën hyrje ku futen punonjesit e Sherbimit të Proves dhe Zyres së Pembarimit, futen dhe gjyqtaret të cilët kanë dhënë vendime gjyqësore për të pandehurit që paraqiten tek **Zyra e Sherbimit të Proves**, gjë e cila ndikon në garantimin/kushtet e sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit të Gjykatës. Gjithashtu në keto Zyra konsumohet energji elektrike, ujë ...etj, shpenzime të cilat nuk llogariten dhe faturohen nga gjykata, për likuidimin e tyre çdo muaj, konstatuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Lushnje, Mat dhe Shkoder.

- **Provat materiale** të çeshtjeve në gjykim apo të gjykuara mbahen në zyrën e buxhetit dhe punonjësi me përgjegjësi materiale është ngarkuar K/D/Buxhetit. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin nr 30. datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 15, ku citohet... “Menaxheri që urdhëron për hyrjen dhe daljen e aktiveve nuk mund të ngarkohet edhe me detyrën e arkëtarit dhe/ose magazinierit. Në institucione të vogla me personel deri në 10 punonjës, ku nuk justifikohet egzistenca e një pozicioni të veçantë pune për arkëtarin dhe magazinierin, mund të vendoset në çdo pozicion tjetër pune. Nëpunësi i ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë

nuk duhet të ngarkohet me detyrën e arkëtarit dhe/ose magazinierit, konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për shkak të doreheqjes të kancelarit, Kryetari i Gjykatës me vendimin nr.260, prot. date 23.11.2018 ka caktuar një sekretarë gjyqësorë për të ushtruar **detyrat ligjore apo kompetencat funksionale të kancelarit të gjykatës**. Veprimi kryer pa u krijuar KLGJ, organi kompetent për emerimin dhe për nderprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin. Sekretarja gjyqësore e caktuar për të ushtruar detyrën e kancelarit të gjykatës, nuk plotëson kriteret e vecanta të parashikuara në Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 56 “Kriteret e vecanta për pranimin e nepunesve civile gjyqësor”, pika 1/a “Te jene diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershem me të, sipas percaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë”. Sekretarja gjyqësore e caktuar në këto detyra ka mbaruar për Agronomi “Hortikulture”. Gjithashtu për kryerjen e detyrës të Kancelarit të Gjykatës është caktuar sekretarë gjyqësorë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Shkoder, që aktualisht vazhdojnë të ushtrojnë këto funksione mbi dy vite. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, **nuk ka zyrë për arkivimin e dosjeve gjyqësore** dhe dokumentacionit administrativ dhe financiar të gjykatës, të cilat mbahen jashtë kushteve normale të ruajtjes dhe sigurisë, në dollapë metalikë nëpër korridoret e gjykatës, në zyrën e kancelarit apo në sekretari. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, përveç zyrës kryesore të arkives në katin e parë, ka krijuar dhe 8(tete) ambiente të tjera për arkive, 2(dy) ambiente në garazhdin e godinës, 2(dy) ambiente në katin e parë, 1(një) ambiente në katin e dytë dhe 3(tre) ambiente në katin e tretë, gjithsej 9(nente) ambiente për arkivimin e dosjeve gjyqësore dhe dokumentacionit administrativ dhe financiar të gjykatës. Nderkohe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka dhënë me qera ambientin e brendshëm (katin nëntokësor), për Bar-Kafe, me sipërfaqe 90 m2, në vlerën 13 500 lekë në muaj, e ardhur kjo që kalon 100% në buxhetin e shtetit. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe Shkoder nuk është punuar sa duhet për **transferimin e fondeve arkivore** në ruajtje të përhershme pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, veprim ky jo në përputhje me udhëzimet e MD.

➤ **Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit**

Nga auditimet e kryera gjatë vitit 2019 pothuajse në të gjitha Gjykatat nuk i është kushtuar rëndësi fazës paraprake të hartimit të PBA-ve, ku në shumë Gjykata konstatohet se në hartimin e PBA-ve është respektuar pjesërisht “gjurma e auditit”, konkretisht:

-nuk është ngritur grupi i punës (EMP) Ekipi i Menaxhimit të Programit për hartimin e PBA-së.

-nuk është kryer hartimi i kalendarit të aktiviteteve për anëtarët e ekipit të menaxhimit të programit për të garantuar respektimin e afateve të përcaktuara në kalendarin e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për hartimin e PBA-së në përputhje me ligjin nr. 9936 date 26/06/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe UMF nr.8 datë 29/03/2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” i ndryshuar me UMF nr.7 datë 28/02/2018, **Kreu 2,nënkreu 2.5.** ‘Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit’ pika 5 , **nënkreu 2.6,** Ligjin nr. 10296 datë 08/07/2010 “Për MFK” i ndryshuar neni 12.

- nuk ka dokumentim të punës së grupit, apo dosje të të dhënave të grumbulluara që janë përdorur për hartimin e PBA-ve.

➤ **Sistemin i prokurimit dhe blerjet e vogla dhe zbatim kontratash**

Janë konstatuar shkelje të ndryshme të dispozitave ligjore të prokurimit publik, nga Autoritetet Kontraktore/Gjykatat që kanë zhvilluar procedura prokurimi gjate viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019, konkretisht:

- Mos caktimi i **personit përgjegjës për prokurimet** në përputhje me pikën 1 të nenit 57 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me Vendimin Nr.797, datë 29.12.2017, ku citohet... “*Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe* dërgon emrin/emrat respektivë në Agjensinë e Prokurimit Publik”, konstatuar kjo ne Autoritetet Kontraktore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korçe, Mat, Kurbin dhe Shkoder.

- Mosplanifikimi si duhet i fondeve qe do te prokurohen gjate vitit, duke mos reflektuar drejt nevojat si dhe vleren e kohes per plotesimin e tyre. Ne te shumten e rasteve kjo ne procedurat e prokurimit me vlere te vogel, per kategorine e puneve, mallrave dhe sherbimeve ne nje vlere deri 100 000 leke gjate gjithë vitit kalendarik. Per rrjedhoje vlere e puneve, mallrave dhe sherbimeve te njejta gjate vitit e ka tejkaluar vleren 100 000 leke. Nga Autoritetet Kontraktore/Gjykatat jane bere ndryshime here pas here ne RPPP, ne te shumten e rasteve keto ndryshime nuk kane qene te argumentuara dhe te justifikuara, per rrjedhoje keto ndryshime nuk jane publikuar nga APP-ja(ka qene mundesia per tu parashikuar qe ne fillim te vitit kur eshte hartuar regjistri). **Kërkesat për punë**, mallra apo shërbime nga sektorët përkatës të Gjyqates, nuk kane qene shumë të qarta ku të kenë një përshkrim të hollësishëm në lidhje me punën, mallin apo shërbimin që kërkohet të prokurohet. Nuk i eshte dhene vemendja e duhur **hartimit Rregjistrimit te parashikimit te procedurave te prokurimit publik dhe rregjistrimit te realizimit** ne fillim te vitit, sipas formateve standard dhe manualit teknik te APP-se, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, Fier, Korçe, Mat, Shkoder, Kurbin dhe Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Vlore.

- Përpara nxjerrjes të urdher prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, njesia e prokurimit ose komisioni i ngritur per kete qellim, **nuk ka siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës** për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve të prokuruara (ne te shumten e rasteve nuk dokumentohen në një procesverbal të veçantë, përpara përllogaritjes së fondit limit, detyruese kjo per te gjitha procedurat e prokurimit, perfshire ketu dhe procedurat e prokurimit me vlere te vogel). Ne disa procedura prokurimi, ne specifikimet teknike, autoritetet kontraktore kane perdorur emra marke apo prodhuesi dhe kane vendosur specifikime te tilla qe i referohen nje marke te caktuar pa percaktuar fjalen “ose ekuivalent”, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, Korçe dhe Shkoder.

- Jane konstatuar në mënyrë të vazhdueshme mangësi dhe parregullsi në një nga fazat më të rëndësishme të procesit të prokurimit, atë të **përllogaritjes së fondit limit**. Në pjesën dërrmuese të procedurave të prokurimit të audituara është vërejtur mungesa e argumentimit dhe dokumentimit nga autoriteti kontraktor, i përllogaritjes së fondit limit të objektit përkatës të prokurimit. Në dokumentacionin e administruar për një procedurë prokurimi, autoritetet kontraktore pasqyrojnë, në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, mënyrën e përllogaritjes së fondit limit, që në të shumtën e rasteve cilësohet se, bëhet nëpërmjet testimit të tregut apo duke u referuar në çmimet e kontratave të mëparshme, por nuk administrojnë dokumentacionin provues për çmimet e marra në konsideratë, ofertat e operatorëve ekonomikë të marra nga ky testim, kontratat përkatëse të mëparshme, si dhe çdo dokument tjetër ku është bazuar në çmimet referuese, konkretisht kjo e mete eshte konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Fier, Kurbin, Korçe, Lushnje, Tirane, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe dhe Vlore.

- Në lidhje me kriteret e pranimit, në mënyrë të vazhdueshme është konstatuar mungesa e **argumentimit të kriterëve të veçanta të pranimit** dhe mospërcaktimi i dokumentit konkret që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në përmbushje të këtyre kriterëve. Pavarësisht faktit që rregullat e prokurimit publik përcaktojnë detyrimin e autoriteteve kontraktore për të argumentuar domosdoshmërinë e vendosjes së çdo kriteri të veçantë pranimit, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit konkret të prokurimit, dhe dokumentuar këtë, si një proces kyç që lidhet drejtpërdrejt me pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë, ky detyrim nuk respektohet nga autoritetet. Në shumicën e procedurave të audituara është konstatuar se këtij procesi nuk i jepet rëndësia e duhur. Edhe në rastet kur, autoritetet kontraktore pretendojnë se, kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar, nëpërmjet mbajtjes së një procesverballi ku pasqyrohen kriteret e pranimit, në këtë procesverball nuk pasqyrohen argumenta specifik, për të justifikuar përcaktimin e kriterit përkatës, duke analizuar natyrën e objektit të prokurimit dhe elementët konkretë të tij, në përputhje me kërkesat e legjisllacionit të prokurimit publik dhe të fushës së objektit që prokurohet. Përveç sa më sipër, në mjaft raste është konstatuar se, autoritetet kontraktore nuk përcaktojnë dokumentat konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë, për të përmbushur kriteret e pranimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në këtë mënyrë jo vetëm shkaktohet konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar, por edhe lihet mundësi për subjektivizëm dhe interpretim gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, konkretisht kjo e mete është konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kurbin, Shkoder, Tirane, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Durres dhe Vlore.

- Sa i takon **hartimit të kriterëve të veçanta të pranimit**, është konstatuar se autoritetet kontraktore hartojnë kriterë pranimit, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit që prokurohet, në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar, minimizimin e konkurrencës dhe ne keqperdorimin e fondeve publike. Në çdo rast, nëpërmjet kriterëve të pranimit, synohet të krijohet bindja se operatori ekonomik zotëron kapacitetet e nevojshme ligjore, profesionale, ekonomike dhe teknike, për realizimin me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, autoriteti nuk mund të bëhet abuziv, duke përcaktuar kriterë pranimit të panevojshme, të cilat bëhen pengesë për pjesëmarrjen e operatorëve të mundshëm ekonomikë që kanë të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës që prokurohet, konkretisht kjo e mete është konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kurbin, Shkoder, Tirane, Gjykatën Administrative të Shkalles se Pare Durres dhe Vlore.

- **Perzgjedhja e operatoreve ekonomik** te ftuar vazhdon te mbetet nje problematike e vazhdueshme. Autoritetet Kontraktore/gjykatat nuk argumentojne dhe dokumentojne procesin e perzgjedhjes, mbi arsytet qe i kane cuar drejt operatoreve te ftuar ne proceduren konkrete. Nuk ftohen operatorët ekonomikë me reputacion ne treg, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kurbin, Shkoder, Tirane, Gjykatën Administrative të Shkalles se Pare Durres dhe Vlore.

- Një problematikë tjetër e përsëritur nga disa autoritete kontraktore/gjykata është mospërcaktimi sipas rregullave të prokurimit publik i kriterëve të kualifikimit lidhur **mbi xhiron mesatare vjetore dhe eksperiencën e ngjashme të mëparshme**, keto te fundit kerkohen të jene per tre vitet e fundit te aktivitetit te operatorit ekonomik, nderkohe sipas parashikimeve te nenit 46 te LPP si dhe neneve 26,27 dhe 28 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014, i ndryshuar, ky informacion kur eshte i mundur duhet te percaktohet per 3 vitet e fundit, nga data e zhvillimit te tenderit. Në kundërshtim me këto rregulla, autoritetet nuk e specifikojnë kriterin në varësi të eksperiencës me sektorin publik apo privat, si dhe nuk bëjnë një ndarje të dokumentacionit përkatës të kërkuar për secilin sektor. Veçanërisht në prokurimet për shërbimet, për eksperiencë të ngjashme, autoritetet kontraktore kërkojnë që ofertuesit të kenë realizuar shërbime të njëjta me objektin e prokurimit, madje përcaktojnë edhe vlerën minimale të shërbimeve të veçanta që duhet të kenë realizuar ofertuesit. Në çdo rast, sipas parashikimeve në dispozitat ligjore të prokurimit publik,

Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë që ofertuesit të kenë përvojë të mëparshme të ngjashme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe nuk mund të përcaktojë zëra specifikë shërbimesh, në përmbushje të kriterit mbi përvojën e mëparshme, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, Fier, Kurbin, Shkoder, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Durrës, dhe Vlore.

- Problematike mbetet, gjithashtu, **përcaktimi i numrit të punonjësve**, të domosdoshëm për realizimin e objektit të kontratës dhe periudha kohore e kërkuar, për sigurimin e tyre. Pothuajse në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk hartojnë analiza teknike të mirëfillta, për të justifikuar numrin e punonjësve të kërkuar, duke u nisur psh, nga grafiku i punimeve dhe orët e punës që duhen për të realizuar secilin prej zërave të preventivit, grafiku i furnizimit apo kryerjes të shërbimit. Për rrjedhojë, përcaktojnë një numër punëtorësh të paargumentuar, të panevojshëm dhe kufizues. Përveç numrit të pajustificuar të punonjësve të kërkuar, vërehet se, periudha e sigurimit të këtyre punonjësve (e cila, shkon deri në tre vjet nga koha e zhvillimit të tenderit) është po ashtu e paargumentuar, kufizon pjesëmarrjen dhe nuk përmbush qëllimin, për të cilin kërkohet ky kriter. Vlen të theksohet se, e rëndësishme për autoritetin kontraktor, është të krijojë bindje se ofertuesi disponon numrin e punonjësve të kërkuar në kohën e ofertimit dhe në vijim për ekzekutimin e kontratës, ndërkohë që periudha tre vjeçare nga data e zhvillimit të procedurës, përveçse është element kufizues, nuk është tregues mbi disponueshmërinë e këtyre punonjësve në vijim, për realizimin e objektit të kontratës. E njëjta problematikë evidentohet edhe në përcaktimin e llojit dhe të numrit të makinerive dhe mjeteve, në procedura për punë publike apo shërbime. Autoritetet kontraktore nuk hartojnë analiza teknike të mirëfillta, por përcaktojnë mjetet, duke u nisur nga emërtimi i zërave të punimeve dhe nuk analizohet secili zë, për të përcaktuar orët e punës dhe rrjedhimisht, numrin e mjeteve dhe makinerive të domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës.

- Mos **analiza e shkaqeve që kanë shkaktuar dështimin e procedurës** dhe korrigjimin e tyre, përpara se të fillojë një procedurë e re, në mënyrë që të bëhet e mundur nxitja e konkurrencës midis operatoreve ekonomike pjesmarres, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, Korçë, Gjykatën Administrative të Shkalles se Pare Vlore.

- Sa i takon procedurës së prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, shkëlja kryesore e konstatuar nga auditimi është përzgjedhja e gabuar e kësaj procedure, në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit publik. Për më tepër, Autoritetet Kontraktore nuk administrojnë dokumentacionin e nevojshëm për të provuar se, plotësojnë kushtet ligjore të përdorimit të kësaj lloji procedure, si dhe për të lejuar kontrollin e zbatimit të ligjit. Vërehet një keqinterpretim i legjislacionit të prokurimit publik, i cili çon në përzgjedhje të gabuar të procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në këtë rast. Për më tepër, gjatë procesit të auditimit, ka rezultuar se, autoritetet kontraktore nuk analizojnë shkaqet e mundshme, që kanë çuar në dështimin e procedurave të mëparshme të prokurimit të zhvilluar një vit më parë, për të reflektuar dhe marrë masat e nevojshme në korrigjimin e tyre, si dhe nuk pasqyrojnë informacion nëse këto autoritete kanë kryer ndryshime në dokumentat e tenderit, sikurse kërkohet në ligj dhe në rregullat e prokurimit publik. Nga auditimet e kryera rezulton se, kryesisht procedura **“Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”** është përdorur nga Autoritetet Kontraktore me pretendimin se, ndodhen në kushte të nevojës ekstreme, për objektin që kërkohet të prokurohet. Autoritetet kontraktore, nuk argumentojnë dhe provojnë plotësimin e kushteve ligjore për këtë rast, konkretisht, nuk justifikojnë rrethanat e paparashikuara, që i kanë çuar këto autoritete në pamundësi për të planifikuar në kohë nevojat e tyre, me qëllim përmbushjen e këtyre të fundit nëpërmjet procedurave konkurruese, sipas parashikimeve ligjore. Në rastet kur, Autoriteti Kontraktor ka pasur mundësi të parashikojë në kohë nevojën përkatëse për objektin e prokurimit, por me mosveprimet e tij, ka sjellë “krijimin e një situatë emergjente”, përzgjedhja e procedurës së prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, është konsideruar në

shkelje të dispozitave ligjore për prokurimin publik, me e theksuar keto raste jane konstatuar per periudhen 2016 dhe 2017(me e theksuar kjo per sherbimet e sigurise dhe te ruajtjes).

- Sa i takon procesit të vlerësimit të ofertave të dorëzuara nga operatorët pjesëmarrës, në shumicën e rasteve është konstatuar shkelje e dispozitave ligjore të prokurimit publik, **në kualifikimin e operatorëve që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit apo skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret ose mund të kenë devijime të vogla, që nuk i ndikojnë vlefshmërisë së ofertës.** Madje, në disa raste konstatohet veprime të KVO-se me dy standarde në vlerësimin e ofertuesve. Jane konstatuar raste të pjesëmarrjes së bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku në marrëveshjet respektive të bashkëpunimit nuk janë përcaktuar elementët konkretë të punëve, mallrave apo shërbimeve që do të kryejë secili prej operatorëve për kontratën përkatëse, duke e bërë objektivisht të pamundur vlerësimin e drejtë të këtij bashkimi në ato raste kur autoriteti nuk ka kryer sqarimet e nevojshme. Për pasojë, gjendemi përballë një vlerësimi jo real nga autoriteti kontraktor, të ofertës së bashkimit të operatorëve në këto raste(me e theksuar kjo per blerje karburanti). Në procedurat e prokurimit për punë publike, në disa raste, edhe pse në kriteret e kualifikimit është kërkuar realizimi me sukses i punëve të ngjashme, konstatohet se autoritetet kontraktore skualifikojnë ofertuesit me pretendimin se, në preventivat e punëve të ngjashme të realizuara nga këta ofertues nuk kanë të njëjtat zëra punimesh me preventivin objekt prokurimi, ose raportet e zërave të njëjtë nuk janë përpjestimore në lidhje me vlerën totale të punimeve, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, Korçe, Mat dhe Shkoder.

- Mungesa e dokumentimit nga autoritetet kontraktore për **verifikimin e dokumentacionit origjinal të operatorit ekonomik fitues** është një mangësi e konstatuar disa herë gjatë auditimit. Edhe pse autoritetet kryejnë verifikimin fizik të dokumenteve të paraqitura nga operatori fitues, ky verifikim nuk dokumentohet me shkrim ne nje procesverbal te vecante dhe të bëhet pjesë e dosjes të procedurës së prokurimit, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, Fier, Kurbin, Mat, Lushnje.

- **Mos monitorim i zbatimit te kontratës** per cilesine e realizimit te kontrates, veçanarisht per zbatimin e kontrates te lidhur me operatorin ekonomik fitues per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise ne gjykate. Mos hartimi i raporteve periodike apo vjetor te monitorimit te cilesise se realizimit te sherbimit. **Mos plotesimi dhe dergimi ne APP i formularit te zbatimit te kontratave** te lidhura nga autoriteti kontraktor gjate vitit 2018, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, Fier, Korçe, Mat, Shkoder, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Durres.

- **Mos realizimi i procedurave te prokurimit sipas afateve te parashikuara në RPPP,** per shkak te fillimit me vonese ose ankesave te bera nga OE. Mos nxitja e pjesmarrjes dhe konkurences midis operateve ekonomik konkurues ne procedurat e prokurimit te zhvilluara nga autoriteti kontraktor, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, Fier, Kurbin dhe Shkoder.

- Ne disa procedura prokurimi me objekt sherbim mirembajtje pajisje, apo makineri, nuk percaktohen zerat konkret te mundshem te sherbimit si dhe pjeseve te kembimit qe do te kryhen, gje e cila ka penguar ne krijimin e nje ideje te qarte te operateve ekonomik ne pergatitjen e ofertes ekonomike si dhe ka penguar krahasushmerine e ofertave per kerkesat e objektit te kontrates. Praktikes te sherbimit dhe likujdimit i **mungon procesverbali i konstatimit te difektit apo i sherbimit qe kerkohet te kryhet** (preventivi), si dhe procesverbali per punen e kryer ne fakt nga ofruesi i sherbimit, konfirmuar nga marresi ne dorezim/perfaqesuesi i gjykates, perpara se te behet likujdimi. Me e theksuar kjo e mete ne rastet e riparimit te mjeteve te transportit ne perdorim te gjykatave, mirembajtjen e paisjeve elektronike, elektrike, teknike etj, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, Fier, Kurbin dhe Korçe.

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ne te shumten e rasteve nuk dokumenton në një procesverbal të veçantë rastet e **mos njoftimit të operatorëve ekonomik brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë** mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, apo rastet kur operatori ekonomik ne **objektin e ushtrimit te veprimtarise nuk ka te perfshire objektin e prokurimit.** Konstatohen raste te skualifikimit te operatoreve ekonomike ne menyre te pa drejte, me argumentin se nuk kane te perfshire ne ushtrimin e veprimtarise objektin e prokurimit. Jo domosdoshmerisht duhet te jete i specifikuar ne menyre te njejte sipas emertimit te objektit te prokurimit, siç ndodh ne rasin e sherbimeve te riparimit apo mirembajtjes, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, Fier, Kurbin, Mat, Lushnje.

- Ne procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të realizuara në sistemin elektronik nuk është **printuar dhe bërë pjesë e dosjes “Raporti përfundimtar i procedurës së prokurimit”**, të gjeneruar nga sistemi elektronik, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Fier, Kurbin, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe dhe Vlore.

- Mos percaktimi sakte i karakteristikave te punes, mallit apo sherbimit te kerkuara ka bere qe edhe **marrja ne dorezim** e punes, mallit apo sherbimit te jete formale, duke mos shenuar ne procesverbal/aktin e kolaudimit/monitorimit karakteristikat e punes, mallit apo sherbimit te marre ne dorezim(*përdoret një tip akt marrje në dorëzim apo procesverbali*). Ne disa raste rezulton se: puna, malli apo sherbimi nuk eshte marre ne dorezim me procesverbal/akt kolaudim/raport monitorimi, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe Korçe.

- Megjithese procedura e prokurimit per nje artikull apo grup artikujsh me te njejten funksion apo perberje eshte **realizuar nje here ne sistemin elektronik** (SPE), sipas formularit Nr.3, rezulton te jene zhvilluar dhe procedura prokurimi ne forme shkesore, me vlere deri 100 000 leke pa tvsh gjate vitit, per ate artikull apo grup artikujsh me te njejtin funksion, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Kurbin.

- Në procedurat e prokurimit me vlere te vogel te zhvilluar ne sistemin e prokurimit elektronik, **Ftesa per oferte e pergatitur nga komisioni i prokurimit me vlere te vogel, nuk eshte sipas formatit standard** dhe manualit teknik te APP-se(formularit Nr.3). Ne disa raste ne ftesen per oferte nuk jane percaktuar te gjitha te dhenat e nevojshme qe lidhen me objektin e prokurimit, te dhenat teknike te mallit/sherbimit/punes qe prokurohet. Ne rastet specifikike nuk eshte kerkuar plotesimi i nje ose disa kriterëve te veçanta, dokumentacioni perkates provues, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe Kurbin.

- Jo ne pak raste eshte konstatuar se, anetaret e komisionit te prokurimit me vlere te vogel nuk **deklarojne mbi gjendjen e konfliktit te interesit**, ne momentin e perfshirjes ne komisionin e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe ne momentin e hapjes se ofertave ne procedurat perkatese te prokurimit, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korçe, Shkoder dhe Kurbin.

- Per procedurat e prokurimit me vlere te larte, rezultojne raste te mos **arkivimit te dosjeve tenderave** të realizuar nga Autoriteti Kontraktor gjate periudhes objekt auditimi, në përputhje me afatet e parashikuara në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, me ndryshimet përkatëse, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Durres.

- Për procedurat e prokurimit me vlere te vogel te zhvilluara ne sistemin e prokurimit elektronik, nuk eshte bere arkivimi i procedures se prokurimit ne sistem, faza “Arkivo tenderin” eshte e pa perfunduar, konstatuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- **Per te gjitha te metat dhe mangesite e konstatuara nga auditimet e kryera gjate vitit 2019, eshte konkluduar ne dhenien e 61 rekomandimeve, per sistemin e prokurimeve me vlere te larte dhe vlere te vogel.**

Vlen te permendet se: Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-se nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. APP-ja ka dhene rekomandime dhe ka nxjerre urdhera dhe udhezime per dhenie asistence Autoriteteve Kontraktore/personit/personave pergjegjes te prokurimit ne raste nevojte/kerkese. Ne opinionin e auditit, personat e perfshire ne procedurat e prokurimeve kane nevojte per trajnime te veçanta ne fushen e prokurimeve. Autoritetet Kontraktore, nuk kane te perfshire ne strukturen e tyre/organike specialist prokurimesh, ne komisionet e ngritura nga Kryetari i Autoritetit Kontraktor perfshihen punonjes qe nuk kane pervahe/eksperience ne fushen e prokurimeve per rrjedhoje shkeljet dhe mangesite kane qene dhe vazhdojne te jene evidente, megjithe rekomandimet e lena per zbatim nga grupi auditimit. Disa Autoritete Kontraktore kane punësuar me kontratë eksperte të jashtëm për procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të zhvilluara gjatë periudhes objekt auditimi, kjo në përputhje me pikën 1 paragrafi tretë të nenit 57 të VKM-së Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Por dhe ne keto raste procesi i prokurimit eshte ndjekur nga nje person i vetem dhe prania e punonjesve te tjere ne komisione ka qene formale.

Nisur per sa trajtuam me larte, meqenese objektet e prokurimit jane te njejta gjate vitit dhe per te gjitha gjykatat, konkretisht: Sherbimet e Sigurise dhe te Ruajtjes, Blerje Pajisje Elektronike, Blerje Pajisje Mobilje, Blerje Karburanti, Blerje shtypshkrimesh, Blerje Leter A4, Blerje Kancelari...etj, procedurat e prokurimit te perqendrohen dhe te kryhen nga organi qendror, KLGJ. Kjo do te ndikojte ne rritjen efektivitetit te perdorimit te fondeve publike, do te ule shpenzimet administrative per zhvillimin e procedurave te prokurimit ne gjykata, kerkesa thelbesore te LPP.

- **Sistemin e pagave dhe pagesave**

1- Në lidhje me shërbimin postar konstatohet se fatura e operatorit “Posta Shqiptare” shoqërohet në disa raste me kopje të rregjistrimit postar mujor të operatorit, por nuk ka një dokumentacion tjetër në gjykatë që të verifikojë se sa nga këto njoftime janë kryer nga nëpunësi/ftuesi i gjykatës dhe sa nga këto janë dërguar nëpërmjet zyrës postare. Nga ekzaminimi i rregjistrimit postar rezulton se vlerën më të lartë në totalin e faturave e zënë flet thirrjet për njoftime të palëve për datat e zhvillimit të seancave gjyqësore dhe njoftimeve të akteve, ndërkohë që ky shërbim duhet të parapaguhet nga palët ose të përdoren menyrat e tjera të njoftimit në zbatim të KPC nenet,128-144 dhe 154-158. Nga dokumentacioni i audituar rezulton se nuk ka një dokument të shkruar dhe të miratuar për procedurat që duhet të ndiqen për njoftimet, personat përgjegjës si dhe arkëtimet për këto shpenzime në zbatim të nenit 156 pika b), paragrafi dytë të KPC “***Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet tarifa, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.***”

Duke qënë në nivel të lartë në raport me totalin e shpenzimeve operative vjetore dhe mungesa e një procedure të qartë kontrolli dhe monitorimi si dhe mungesa e dokumentacionit të brendshëm të gjykatës çënohet parimi i përdorimit me efektivitet,

efiçencë dhe ekonomi i burimeve financiare. Ky ze perben 17% totalit te shpezimeve te gjyqesorit cka perben nje risk te larte per keto shpenzime.

2.Pagesa per tarifat e Psikologëve

Në kushtet kur për shërbimin e ofruar nga psikologët e thirrur nga gjykata nuk ka tarifa ligjore të përcaktuara dhe të publikuara si dhe rritjes së numrit të çështjeve për gjykimin e të miturve, në kuptim të menaxhimit të fondeve buxhetore me ekonomi, gjykata nuk ka analizuar dhe vendosur standarte mbi tarifat për këtë shërbim. Nuk ka referenca të sakta në rastin e tarifës së shërbimit të Psikologut Vlerësues si ekspert dhe Psikologut Asistues në seancën gjyqësore.

Për punën e kryer jashtë kohës normale të punës dhe punën e kryer në ditë pushimi e festash zyrtare, VKM Nr. 463, datë 16.06.2011 si dhe udhëzimi nr.16, datë 20.07.2011 mbi zbatimin e vendimit nr .463 nga ana e gjykatave nuk interpretohet dhe zbatohet sipas një standardi.

Problemet në lidhje me zbatimin e VKM nr. 463 janë :

- Në disa gjykata pagesa e gjyqtarëve të gatshëm sipas grafikut bëhet për të gjitha ditët e gadishmërisë në disa të tjera vetëm kur gjykohen çështje.
- Sekretarët gjyqësor në disa gjykata përfshihen në grafikun e shërbimit në disa të tjera nuk përfshihen.
- Nuk zbatohet e plotë procedura si ajo para kryerjes së punës, gjatë kryerjes së punës dhe në përfundim të punës, me qëllim të leri gjurme puna mbi kohën normale të punës.

➤ **Sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik**

Në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare në përgjithësi është zbatuar drejt VKM nr. 248, datë 10.04.1998, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore” i ndryshuar por janë konstatuar edhe disa mangësi të karakterit teknik të cilat i paraqesim me poshtë :

- Në disa gjykata zbatohet parimi i kontabilitetit të **arkëtimit dhe pagesave**, në disa parimi i të **drejtave dhe detyrimeve të konstatuara** (parim mbi të cilin duhet të mbahen i përcaktuar në VKM nr.248 është parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara).
- Në disa gjykata akoma nuk është perfeksionuar si duhet mbajtja e informacionit financiar/kontabilitetit në programin financiar ALFAWEB.
- Në disa gjykata akoma nuk mbahet ditari i të ardhurave edhe pse ligji detyron deklarimin mujor online të tyre në sistemin e tatim-taksave, nxjerrja e këtyre të dhënave bëhet vetëm nëpërmjet të dhënave nga degët e thesarit .
- Detyrime (shpenzime) që i takojnë një viti ushtrimor nuk pasqyrohen fare në bilancet e këtij viti por si shpenzime të vitit pasardhës (*shkelet parimi i të drejtave të konstatuara*).
- Në disa raste vlerat e projekteve të rikonstruksionit apo ndërtimeve të reja edhe pas marrjes në dorëzim të objekteve nuk i shtohet vlerës së ndërtesës, por pasqyrohet në postin e projekteve.
- Disa gjykata kanë automjete që nuk janë në gjendje pune prej disa viteve për të cilat duhet të ishin kryer procedurat e nxjerrjes nga përdorimi. Për sa më sipër, arrijmë në konkluzion se punonjësit e degëve të buxhetit dhe kancelarët duhet të veprojnë menjehere për këto grup aktivesh dhe të tjera.

➤ **Teknologjinë e informacionit**

1- Masat e marra nga gjykatat për Sigurinë Fizike dhe Mjedisore për **Dhomen e Serverit** janë të pamjaftueshme dhe jo në përputhje me Rregulloren e AKSHIT mbi “Ndertimin e dhomes së serverit”. Prania e dritareve nuk plotëson kushtet e percaktuara në Rregulloren e AKSHIT mbi ndertimin e dhomes së Serverit dhe cenon sigurinë fizike të dhomes (xhamat e dritareve nuk janë të temperuara). Ambjenti nuk pajiset me sensor për detektimin e lëvizjeve në kundërshtim me Rregulloren e AKSHIT, në të cilën specifikohet: “Hyrja në dhomë duhet të jetë e siguruar me anë të një sistemi elektronik dhe natyrisht të ketë sistem alarmi në rast thyerje të saj”. Në dhomën e serverit mbahen objekte që nuk kanë lidhje me funksionin e saj (për mungesë ambjenti, dhoma e serverit përdoret si magazinë). Nuk ka kamera vëzhgimi të cilat mundësojnë identifikimin e personave të cilët aksesojnë dhomën e serverit (mungon paneli i monitorimit). Hyrja në dhomën e serverit nuk bëhet nëpërmjet akses kontrollit. Sistemet nuk janë të mbrojtura nga dëme që mund të shkaktohen nga zjarri (dhoma nuk është e veshur me materiale zjarrduruese). Dyshemese i mungon shtresa teknologjike (zjarrduruese). Mungon dera zjarrduruese, të pakten për një kohë rreth një orë, etj. Konsiderohet me risk mbajtja e sistemit të kondicionimit të qëndëruar në dhomën e serverit, konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, Fier, Tiranë, Korce, Shkoder, Gjykatën Administrative të Shkalles së Parë Korce, Durres dhe Vlore.

2- Nuk është caktuar **personi përgjegjës për monitorimin e kamerave** të vëzhgimit/sigurisë dhe vendi ku do të mbahet/ruhet DVR-ja, kjo e fundit mbahet në zyrën e Kryetarit të Gjykatës, veprim ky jo në përputhje me Rregulloren e datës 02.12.2008 të AKSHI-it, pika 2, paragrafi i dytë, pika 3, paragrafi i tretë, konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Mat.

3- **Mos instalimi apo mos funksionimi i pajisjes akses kontrolli elektronik** për monitorimin e hyrje-daljeve të personelit në godinën e Gjykatës, konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkoder, Gjykatën Administrative të Shkalles së Parë Korce, Durres dhe Vlore.

4- Akoma nuk është zgjidhur problemi i **mirembajtjes të sistemit ICMIS**, aktualisht ky sistem mirembahet nga Specialistet e IT-së në gjykata, në rastet e avarisë së rëndë do të përbejë shkak për ndërprerjen e punës në gjykata.

5. Në vitin 2017 ka përfunduar kontrata e lidhur midis Ministrisë së Drejtësisë dhe operatorit ekonomik për mirëmbajtjen e sistemit ICMIS (e cila përfshinte edhe realizimin e backup-eve). Gjykatat kryejnë procedurën e kontrolleve dhe realizimit manual të backup-eve, në raste kur nuk mundësohet backup-i automatik i planifikuar.

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce, konsiderohet me risk të lartë kalimi i tubacioneve të kaldajës në dhomën e serverit, e cila pavarësisht izolimit ndikon në rritjen e temperaturës në periudhën që kaldaja është në përdorim.

- Në disa gjykata gjithashtu problem ka pasur dhe në drejtim të **mirembajtjes të programit financiar Alpha Web**, për shkak të mos zhvillimit të procedurës me objekt prokurimi “Sherbimi i mirembajtjes të programit financiar alpha web për vitin 2019).

V. Rekomandimet e auditimit

Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë fokusuar në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes në gjykata, nëse:

- Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Asetet publike të gjyqësorit janë ruajtur dhe përdorur me efektivitet;
- Veprimtaritë e gjykatave janë në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara.
- Objektivat kryesore të përcaktuara në programet dhe planet janë realizuar.
- Të ardhurat nga shërbimi gjyqësor derdhen në kohë në buxhet, përdorimi i pjesës së përfituar nga këto të ardhura dhe monitorimi i tyre.

Bazuar në raportet finale të auditimit, për këtë periudhë, konstatohet se në gjykata bëhen përpjekje dhe ka vlerësim nga ana e Titullarëve, Kancelarëve dhe K/Degëve të Buxhetit për të realizuar treguesit buxhetor në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi që veprojnë në këtë fushë, si dhe administrimin dhe ruajtjen e aseteve publike.

Por krahas punës së mirë, vërehen edhe mangësi të cilat vijnë si rezultat i neglizhimit të përditësimit me aktet ligjore e nënligjore nga ana e k/degëve të buxhetit, kancelarëve, moskuptimit të drejtë të kontrollit të brendshëm, mospasja e rregulloreve të brendshme në gjykata, ndryshimet e shpeshta ligjore si dhe mosqartësia e zbatimit të ligjeve të posaçme për gjyqësorin.

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit, kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.

Sistemet e kontrollit në gjykata janë efektiv dhe funksionojnë.

▪ Përcaktimi i përgjegjësive, propozimet për rekomandime.

DAB e ka konsideruar një nga sfidat e saj ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, rritjen e cilësisë së tyre, si dhe forcimin e bashkëpunimit me njësitë e audituara, që ato të shërbejnë për ndreqjen e parregullsive e gabimeve, dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm. Këtë e bën duke u përpjekur që:

1. Të përmirësojë cilësinë e rekomandimeve dhe të rrisë dobinë e tyre për njësinë e audituar.
2. Të rrisë bashkëpunimin me njësinë e audituar, me synim që rekomandimet të diskutohen dhe pranohet paraprakisht, duke rënë dakord për zbatimin e tyre.
3. Të kërkojë respektimin e afatit ligjor të raportimit të masave të marra nga subjekti.
4. Të kërkojë caktimin e një zyrtari përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin e realizimit të tyre.
5. Sigurimin që sistemi i bashkëpunimit për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit është i dokumentuar në mënyrën e duhur.
6. Sigurimin se është kthyer përgjigje në kohën e duhur, si dhe janë ndërmarrë veprimet korrigjuese në zbatim të rekomandimeve.
7. Zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që lidhen me çështjet e auditimit.

Bazuar në procedurat e punës në fuqi, është kryer brenda afatit ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit në të gjitha njësitë e audituara, për t'u siguruar se ato kanë ndërmarrë të gjitha masat korrigjuese ose veprimet e duhura përmirësuese për zbatimin e rekomandimeve dhe këshillave të auditimit.

Krahas problematikës së ngritur në seksionin e mësipërm vihet re se për gjetjet e konstatuara nga strukturat audituese **është përcaktuar plotësisht përgjegjësia**. Ky fakt konsiderohet si një tregues pozitiv i performancës së auditimit të brendshëm dhe tregon se rezultatet e punës janë shtrirë përtej konstatimit të gjetjeve.

Në bazë të manualit të ri janë kryetarët e gjykatave që japin masa mbi bazën e gjetjeve të auditimit.

Është përgjegjësi e kryetarëve të reagojnë mbi bazën e raportit final të auditit.

Përcaktimi i përgjegjësive ka sjellë efekt pozitiv dhe në dhënien e propozimeve për uljen e pasojave të mangësive dhe shkeljeve të konstatuara. Megjithatë, si rezultat i përmirësimit të cilësisë së punës dhe parandalimin e mospërsëritjes së shkeljeve dhe kthimin në fenomene negative në të ardhmen për subjektet e audituara, struktura e auditimit kanë rekomanduar masa administrative të cilat konsistojnë në:

- **Arkëtimin e detyrimeve në arkën e shtetit në shumat e gjetura nga auditimi, dhe të pranuarat si dëm ekonomik.**
- **Masa teknike dhe organizative në përmirësimin e punës në gjykatë.**
- **Në aspektin organizativ dhe prokurime publike.**
- **Në administrimin sa më të mirë ekonomik nga gjykatat, të aktiveve e shërbimeve gjyqësore ndaj popullatës që mbulojnë.**
- **Masat administrative i kemi lënë në autoritet të kryetarëve mbi bazën e gjetjeve nga auditimi.**

Në zbatim rekomandimesh kemi patur parasysh si vijon:

Rekomandimet e dhëna bazuar në natyrën e gjetjeve janë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ndreqjen e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike, zhdëmtimin e vlerave për dëme të shkaktuara nga persona përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht.

▪ Propozimet për strukturën e rekomandimeve

Në ushtrimin e funksionit të saj, Njësia audituese përqendron një pjesë të madhe të përpjekjeve të saj në dhënien e rekomandimeve për Kryetarët, të cilat synojnë përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe veprimtarisë së gjykatave për arritjen e objektivave. Për këtë qëllim, vlerësimi i sistemeve të MFK dhe veprimtarisë së gjykatave shoqërohet me dhënien e rekomandimeve, të cilat duhet të jenë të sakta, realiste dhe të zbatueshme. Në përgjithësi rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2018 do të klasifikoheshin në grupet e mëposhtme:

1. Rekomandime që lidhen me *përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes, të politikave dhe procedurave të hartimit të strategjive, si dhe përcaktimit të objektivave.*

Në gjykatat e audituara përmirësimi i strukturave vendimmarrëse dhe veprimtarisë së tyre, riorganizimi i cili mundëson ndarjen e detyrave (arka, magazinë, financë, punonjës me ndjekjen e taksave) dhe shpeshherë rishikimi i funksioneve të tyre dhe menaxhimit të lartë, hartimi i rregulloreve, ndjekjeve e shërbimeve gjyqësore, dhe ruajtjes të aseteve publike.

2. Rekomandime për përmirësimin *e proceseve të implementimit të politikave, kuadrit ligjor e procedural të brendshëm e të jashtëm* që drejton veprimtarinë e gjykatave (vendosja e procedurave, rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve, autorizimeve, ndarja e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo zyrtari dhe masa antikorrupsion).

3. Rekomandime për përmirësimin *e sistemit të menaxhimit financiar* me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet i fondeve publike (rritja e

cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, vendosja e rregullave të kujdesshme për parandalimin e mashtrimit dhe vjedhjes, ruajtjen e aseteve etj).

4. Rekomandime për *zhvillimin profesional të punonjësve* në subjektet publike dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar (trajnim për programin Alpha web).

5. Rekomandime për *ngritjen dhe zhvillimin profesional të kapaciteteve kontrolluese në gjykate (gjykatat e mëdha). Ne te gjitha gjykata e audituar jane lene keto si rekomandime thelbesore.*

▪ **Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit Gjykatat**

Sikurse përcaktohet dhe në misionin e auditimit të brendshëm, objektivi strategjik i tij është *dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit dhe shtimin e vlerës së subjektit* nga kryetarët e gjykatave dhe pushteti gjyqësor.

Arritja e këtij objektivi përcaktohet në një masë të madhe nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të subjekteve publike mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve. Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien, por dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor. Nëse auditimi i brendshëm do të luajë një rol pozitiv, i cili do të konsistonte thjesht në dhënien e rekomandimeve, që jo rrallë rezultojnë të paqarta dhe të paaplikueshme, atëherë nuk do të bëhej fjalë për përmbushje të misionit dhe objektivave të tij strategjikë, pra për vlerë të shtuar të subjektit të audituar apo përmirësim të veprimitarisë së gjykatës.

Me shkresën nr.4823 Prot, datë 01/10/2019, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet Kryetarës së KLGJ-së ju kërkon informacion 13 gjykatave të audituara në lidhje me progresin që është bërë në zbatim të rekomandimeve të lëna në aditimin e kryer gjatë vitit 2018.

Gjykatat kanë kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar, ku kanë raportuar në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimeve. Nga raportimet e tyre rezulton se janë marre masa konkrete nga ana e gjykatave për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Në shumicën e rasteve janë zbatuar rekomandimet dhe në raste të tjera zbatimi i tyre është në proces e sipër. Nga 180 janë zbatuar 136 rekomandime dhe 54 janë në proces.

Ky tregues përbën dhe vlerësimin që i bëhet punës audituese.

VI. Analiza e kapaciteteve të strukturave audituese

▪ **Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB.**

Ndonëse ndërmerren iniciativa të rëndësishme për të realizuar funksionimin normal të gjykatave, veprimtaria e tyre parashikohet të jetë e shoqëruar edhe me risqe të fushës gjatë aktivitetit. Në përmbushjen e objektivave dhe programit të saj, struktura e AB ka parë me interes dhe njohjen e risqeve, nga të cilat si më të mundshmit vlerësohen të jenë:

- Niveli i kualifikimit, aftësitë profesionale të stafit të strukturës së AB.
 - Procedurat e domosdoshme për miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve ligjore e nënligjore (qarkullimi i dokumentacionit apo vonesat), të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për ndjekje dhe zbatim.
 - Burimet njerëzore dhe sigurimi i bazës së nevojshme me burime materiale dhe njerëzore për kryerjen normale të veprimitarisë.
- Ndryshimet ligjore dhe të akteve në fuqi për pushtetin gjyqësor.

▪ Kapacitete audituese

Sigurimi i cilësisë i përcaktuar në kapitullin VII, standardi 1300 të IIA-së përcakton detyrimin që;

”Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguridhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.”

Qëllimi i këtij programi është të krijojë një siguri të arsyeshme në përputhje me standardet dhe praktikatat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit e standardeve të tjera të aplikueshme. Pjesë e rëndësishme e sigurimit të cilësisë është mbikëqyrja dhe rishikimi i jashtëm i veprimtarisë së strukturave audituese.

Përputhja me standardet e aplikueshme shkon përtej pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e miratuara pasi përfshin: vlerësimin e performancës së vetë njësisë së auditimit dhe nivelin e efektivitetit të saj.

Në manualin e auditit të Brendshëm kapitulli VI, pika 7.2.1 përcaktohet qartë se vlerësimi i jashtëm i cilësisë së njësive të auditimit të brendshëm të ngritura pranë subjekteve publike kryhen nga Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Ndërkohë që vetë njësitë e audituara kanë dhënë komente zyrtare mbi punën dhe cilësinë e NJAB-së me raportet përkatëse.

Raportet e vlerësimit të cilësisë së punës së auditit na kanë shërbyer për përmirësimin e punës tonë më tej.

▪ Burimet e AB dhe cilësia.

Në realizimin e misionëve të parashikuara sa më sipër sistemi i auditimit, do të përdorë burimet njerëzore e materiale të vëna në dispozicion nga KLGJ për vitin 2019.

Çdo raport auditimi, është një produkt publik dhe si i tillë duhet të certifikohet.

NJAB është përqendruar, në respektimin e Standardeve të Raportimit për Auditimin e Brendshëm me qëllim hartimin e raporteve të besueshme, koncize, të sakta, të bazuara në fakte, dhe mbi të gjitha të vlefshme në ndihmë të menaxhimit për përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit të operacioneve financiare dhe të drejtimit. Rritja e cilësisë së raportimit do të vijojë të jetë prioritet dhe nën monitorim sistematik. Raportet janë hartuar në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të Udhërrëfyesit specifik. Janë respektuar standardet në fushën e raportimit për sa i përket përmbajtjes, cilësisë, qartësisë dhe dobishmërisë së kësaj faze të procesit auditues.

Do të vijojmë trajnimin e përvitshëm të organizuar nga Ministria e Financave. Burimet e auditimit janë menaxhuar me efikasitet dhe në funksion të realizimit të planit vjetor duke u kujdesur për kostot e auditimit.

Rekomandimet e dhëna bazuar në natyrën e gjetjeve janë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ndreqjen e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike, zhdëmtimin e vlerave për dëme të shkaktuara nga persona përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht.

NJAB është përqendruar, në respektimin e Standardeve të Raportimit për Auditimin e Brendshëm, me qëllim hartimin e raporteve të besueshme, koncize, të sakta, të bazuara në fakte dhe mbi të gjitha të vlefshme në ndihmë të menaxhimit për përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit të operacioneve financiare dhe të drejtimit. Rritja e cilësisë së raportimit do të vijojë të jetë prioritet dhe nën monitorim sistematik.

VII. Konkluzione

▪ Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e konceptuar për të shtuar vlerën e përmirësuar në veprimtarinë e gjykatave. Auditimi i brendshëm ndihmon KLGJ-ne për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes. Ai mbështet menaxhimin duke dhënë siguri që kontrollet janë ngritur në pajtueshmëri me rregullat dhe standardet dhe sipas parimeve të shëndosha të menaxhimit financiar, dhe njëkohësisht ofron rekomandime për përmirësimin dhe funksionimin efikas të këtyre kontrolleve.

Si një nga “tre shtyllat” e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, funksioni i auditimit zhvillohet dhe përmirësohet në vazhdimësi në mënyrë që të fitojë rolin e tij të ri modern si vlerësues dhe këshillues për sistemet dhe të sigurojë arritjen e objektivit të tij strategjik, gjithnjë në pajtueshmëri me standardet dhe praktikën më të mira.

Në këtë këndvështrim qëndrimi ynë është dhe do të jetë gjithnjë kritik kundrejt problemeve dhe risqeve që ndikojnë në përmbushjen e misionit për një qeverisje të mirë në gjyqësor duke shprehur bindjen se sot gjyqësori është pararojë e menaxhimit të mirë dhe të shëndoshë të aseteve publike dhe paranë publike në R.SH.

▪ Prioritetet për vitin 2020

Prioritetet kryesore strategjike i janë referuar rritjes së efikasitetit të burimeve të auditimit, të orientuara nga analiza periodike e marrëdhënies burime të përdorura- produkte konkrete.

Për këtë, janë përcaktuar 4 prioritet kryesore si vijon:

1. Përmirësimi i procesit të vlerësimit të rrezikut
2. Zgjerimi i aftësive për të monitoruar rreziqet emergjente
3. Qenia më të dobishëm me impakt konkret në arritjen e objektivave të KLGJ-së
4. Reduktimin e kostove të auditimit pa kërcënuar mbulimin e fushave me risqet më të larta.

Duke synuar si në vijim:

- ◆ Zhvillimi i kapacitetit institucional të DAB;
- ◆ Përmirësimi i kapaciteteve audituese dhe cilësisë së auditimit;
- ◆ Rritja e numrit dhe cilësisë së auditimit të performancës;
- ◆ Përgatitja dhe konsolidimi i auditimeve të teknologjisë së informacionit;
- ◆ Rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në procesin e auditimit;
- ◆ Forcimi i rolit të DJAB-së kundër korrupsionit dhe bashkëpunimit me KLSH dhe Ministrinë e Financave.
- ◆ Zhvillimi i bashkëpunimit me aktorë të tjerë përkatës brenda vendit.
- ◆ Aplikim i auditimit të performancës

Bazuar në raportet finale të auditimit, për këtë periudhë, konstatohet se në gjykata bëhen përpjekje dhe ka vlerësim nga ana e Titullarëve, Kancelarëve dhe K/Degëve të Buxhetit për të realizuar, treguesit buxhetor në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi që veprojnë në këtë fushë, si dhe administrimin dhe ruajtjen e aseteve publike.

Por krahas punës së mirë, vërehen edhe mangësi të cilat vijnë si rezultat i neglizhimit të përditësimit me aktet ligjore e nënligjore nga ana e kryetarëve të degëve të buxhetit, kancelarëve, moskuptimit të drejtë të kontrollit të brendshëm, mospasja e rregulloreve të brendshme në gjykata, ndryshimet e shpeshta ligjore si dhe mosqartësia e zbatimit të ligjeve të posaçme për gjyqësorin.

Nga ana e auditit është vlerësuar fryma e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit në Gjykatat e audituara për vitin 2019 dhe auditit arrin në konkluzion që:

Pushtetit Gjyqësor, paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e fondeve buxhetore, burimeve njerëzore dhe shërbimeve gjyqësore, pasi ka menaxhuar drejt veprimtarinë e institucionit, ka administruar siç duhet vlerat monetare të vëna në dispozicion, bazuar në rregullat dhe standartet buxhetore.

Raportimet financiare paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale të institucionit dhe i kanë dhënë menaxherit të lartë të gjithë informacionin e duhur për menaxhimin të marre vendime dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, me qëllim përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë si dhe ofrim shërbimesh gjyqësore në gjykatat e audituara.

Hartoi:

Artur MAMADHAJ

Drejtuesi i Njësisë së Auditimit